

# Filimet

Revistë e shkollës së mesme "Vëllazërim-Bashkim"  
Mars 2013 - Ulqin, Nr. 47



# Fjala e redaksise



Tradita paraqet vlerë dhe ne u munduam mos të largohemi nga ajo!

Edhe këtë vit mblozhëm dhe seleksionuam materialet më të mira nga materialet e shumta që kishin mbledhur gjimnazistët për revistën shkollore. Ishte një punë e vështirë por ne me një entuziazëm dhe përkushtim e përfunduam në mënyrë të sukseshtme edhe këtë numër të revistës shkollore. Nga kritikat s'shpëton askush, por duhet të kuptioni që jemi thjeshtë gjimnazistë, e jo gazetarë profesionistë. Shpresojmë që puna jonë do t'i u pëlqejë.

Këtë vitë shpërblejmë nxënësit:

Edona Çapriq I4  
Arnella Hysenaj II2  
Armina Maxhuriq III5  
Valdrin Hajdari IV5

Në nivel të shkollës shpërblehet:

Aneta Popoviq IV1

Lexuesja më e rregullt:

Aida Beqoviq IV4

Kryeredaktoret dhe lektoret:

prof. Hava Pereziqi  
prof. Nepe Peraj

Puna kompjuterike:

Lulzim Gjoni  
Sead Lika

Përzgjedhja dhe renditja e materialeve:

Admir Halili  
Teuta Gjeçbritaj  
Flutur Mustafa

# *Historiku i shkollës*



Para Luftës së II Botërore në Ulqin kanë ekzistuar shkolla të mesme por ato kryesisht ishin të karakterit fetar. Por në vitin 1946, gjegjësisht pas Luftës së II Botërore në qytetin tonë formohet shkolla për nxënësit në drejtim ekonomik e cila punon e varur deri në vitin 1974, dhe atëherë bashkohet me gjimnazin.


Gjimnazi i Ulqinit daton që në vitin 1963, ku formohet si paralele e ndarë e gjimnazit të Tivarit. Pas dy viteve formohet gjimnazi i Ulqinit në dy gjohë : serbo-kroate dhe shqipe i cili punon i pavarur deri në vitin 1974 më pas bashkohen gjimnazi dhe shkolla profesionale, kështu formohet shkolla e mesme.

Ndërtesa e shkollës është ndërtuar nga populli i Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 1969, në shenjë solidariteti për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i atëhershëm i vitit 1968. Që atëherë shkolla e mesme e merr emrin "Vëllazërim-Bashkim" për plotësimin e nevojave të 300 deri 400 nxënësve.

Sot në këtë shkollë mësimin e vijojnë rrëth 1065 nxënës, që ka tregon se edhe pse është bërë ndërtimi i disa kabinetave të reja, shkolla nuk ka madhësi të mjaftueshme për këtë numër të nxënësve. Nxënësit janë të ndarë në 40 paralele, në gjuhën malazeze dhe shqipe. Në gjuhën shqipe ekzistonë 28 paralele me rrëth 740 nxënës dhe në gjuhën malazeze 12 paralele me 325 nxënës.

Gjatë muajve të verës planifikohet rindërtimi i kësaj shkolle, me qëllim që të rritet efikasiteti i energjisë. Na mbetet vetëm të presim vitin 2014, ku sipas planit Ministror do bëhet ndërtimi i një shkolle të mesme të re.

"Vëllazërim-Bashkim"



# Interview me drejtorin e shkollës

Shumë herë e keni bërë të ditur se objekti i tanishëm i shkollës, fillimisht, nuk ishte i paraparë për numër të madh të nxënësve (mbi njëmijë).

1. A është në dukje ndonjë ndërtim i godinës (ndërtuesës) së re apo ndonjë zgjerim i objektit të tanishëm?

Drejtori: I dukshëm, e kemi të paraparë qysh në vitin 2010 që të ndërtohet një objekt i ri. Por Komuna e Ulqinit nuk na e ka aprovuar. Tash duhet një bashkëbisedim me disa ministra për një objekt të ri. Në 2014 do të jenë të parapame ndërtimet. Kemi hyrë në një projekt adaptimi që quhet ngrohja energjetike, domethënë duhen radiatorët, duhet bërë izolimi i pullazit, ndërrimi komplet i bravave dhe rregullimin e nyjeve sanitare. Ky plan është i paraparë të fillojë në verë, por do të shohim.

2. Sa jeni të kënaqur me rezultatet e arritura në mësim?

Drejtori: Po përgjithësisht, në gjysmëvjetor bëhet një analizë e rezultateve. Kur analiza e rezultateve është mbi 50% atëherë kemi kaluar dhe jemi të kënaqur. Nëqoftëse analiza e rezultateve është nën 50% atëherë do të thotë që nuk jemi të kënaqur me ato rezultate. Por siç e dini edhe ju, nxënësit në fund të vittit shkollor angazhohen më tepër dhe përmirësohen në mësim, kanë vullnet më tepër.

3. Numri i madh i mungesave të paarsyeshme vazhdon të mbetet shqetësim për drejtorinë dhe kolektivin. Cilët janë faktorët kryesorë që ndikojnë në shtimin e numrit të mungesave të paarsyeshme?

Drejtori: Problemi kryesor është rrëthina. Rreth 100 metra, ka më tepër se 10 kafeteri. Aty nuk dihet a ikin për jopërgatitje apo për qef. Domethënë i tërhjek rrëthina jashtë, qëndrimi me shoqëri jashtë shkollës ku kalojnë kohë duke pirë kafe janë faktorët kryesorë që ndikojnë në numrin e madh të mungesave të shumta të paarsyeshme ku deri më tanë janë përjashtuar 20 nxënës.

4. Kodeksi etik duhet respektuar. A mund të na thoni çka parashev ky kodeks?

Drejtori: E kemi aprovuar në Këshillin e Arsintarëve. Ky kodeks parashev rregullat të cilave duhet përbajtur mësimdhënësit dhe nxënësit. Në kodeks janë të përshkruara sjelljet, detyrat, ruajtja e orendive.

5. A keni menduar që një ditë veshja të jetë unike në shkollën tonë?

Drejtori: Është vështirë që të zbatohet. Vetë nxënësit janë larguar nga kjo. Nuk ekziston asnje shkolle në Mal të Zi që ka një numër të madh nxënësish sa kemi ne, do të thotë që kjo gjë zbatohet vetëm në shkolla të vogla domethënë ku ka nga 100 nxënës, siç është gjimnazi privat "Drita". Kjo varet edhe nga buxheti, sepse secili nxënës duhet të ketë nga dy palë rroba, se mbështetjen e lagen a dicka e tillë, duhet të kenë tjetrën uniformë (uniformën rezervë), do të thotë duhet të kenë minimumi dy veshje.

6. Çfarë do t'i këshillonit maturantët por edhe nxënësit tjerë?

Drejtori: Maturantët e kuptojnë pjesën e fundit që të angazhohen sa më tepër për provimet e maturës (Matura eksterne apo interne). Do t'i këshilloja që sa më tepër t'i kushtohen mësimit, sepse kjo ndikon në të ardhmen e tyre. Kurse nxënësve tjerë do t'iu lutesha t'iu shëmangjen kafeterive. Pasi që tanë kemi edhe disa angazhime rreth Ditës së Shkollës, si turniri i futbollit mund t'i përkushtohen vetëm mësimit të paktën gjatë kësaj periudhe.

# Interview me pedagogen e shkollës

1. Çfarë ju ka motivuar të zgjidhni këtë profesion?

-Puna me rini është gjithmonë kënaqësi pér njerëzit të cilët janë të lidhur me arsimin.

2. A jeni të kënaqur me këtë profesion?

-Në përgjithësi jam e kënaqur, por në çdo punë ekzistojnë gjërat që mund të ndryshohen.

3. Na shpjegoni në pika të shkurtëra punën e Pedagogut në shkollë?

-Shërbimi pedagogjik i shkollës ka të bëjë me punën edukativo-arsimore, çka do të thotë që puna e pedagogut në shkollë është shumë e rëndësishme dhe ka një ndikim, sepse trajton probleme të ndryshme; sjellja e nxënësve, mosndjekja e mësimit rregullisht, braktisja e shkollës në moshë të re, bashkëpunimi me prindër te nxënësit me aftësi të kuifzuara etj.

Puna e pedagogut ka të bëjë e disa aspekte themelore: organizimi i punës edukativo-arsimore si dhe vlersimi dhe përparimi i kësaj.

Punë instruktive me mësimdhënësit, përkrahja dhe aplikimi i risive sipas reformës dhe menaxhimi i programeve mësimore. Koordinimi i aktiviteteve edukativo-arsimore.

Punë instruktive me përgjegjësit e aktiveve profesionale, ndjekja e zhvillimit të portfoliove të arsimtareve, punë aktive në planin profesional të zhvillimit profesional në nivel të shkollës, punë këshilldhënëse me nxënës, përcjellja dhe vëzhgimi i suksesit të nxënësve etj.

4. A komunikojnë nxënësit e shkollës sonë ndopak me ju, a është numri i tyre i madh apo i vogël (nëse komunikojnë)?

-Komunikimi i nxënësve me mua si pedagoge është shumë i shpeshtë, por në të shumtën e rasteve biseda ime nuk është transparente pér të tjerët, sepse është më efektive kur nxënësit i ruhet privatësia. E gjithë kjo varet edhe nga ana e mësimdhënësve dhe kujdestarëve të paraleleve se sa i udhëzojnë, i drejtojnë te pedagogu pér probleme të ndryshme.

5. Cilat janë problemet më të shpeshta me të cilat ju keni hasur gjatë këtyre viteve që punoni këtu?

-Këto probleme janë të natyrave të ndryshme, njëri ndër më të theksuarit është mungesa në mësim të rregullt, bisedë me nxënësit të cilët kanë vështirësi në mësim etj.

6. A keni marrë pjesë gjatë zhvillimit të orëve? Si ju është dukur atmosfera gjatë orës dhe na thuani dëcka pér nivelinë e orëve në përgjithësi?

-Në bazë të planit të zhvillimit profesional në nivel të shkollës janë planifikuar një numër i konsiderueshëm i orëve pasqyrë, deri më tanë janë realizuar njëzet prej tyre si dhe orë të tjera, në të cilat kam hospituar. Në orët pasqyrë ishin prezant drejtori i shkollës, pedagogu dhe anëtarët e aktiveve. Atmosfera gjatë orëve pasqyrë ishte konstruktive, bashkëpunuese, me përgatitjet që përmbanin elementet strukturale të orës, si dhe arritja e qëllimeve të caktuara.

Gjithmonë në procesin mësimor ka risi dhe është një proces kontinuitiv kjo nuk do të thotë që nuk janë arritur qëllimet, por çdo herë ka se çka të përmirësohet.

7. Cila është porosia juaj pér nxënësit?

-Të jenë të rregullt në mësim, të kenë kontakte të shpeshta lidhur me problemet e tyre me pedagogun, të mësojnë më shumë, dhe të kenë respekt ndaj mësimdhënësve, sepse shkolla Jonë ofron arsimim dhe edukim kualitativ pér të gjitha gjeneratat e reja si parakusht pér kryje të suksesshme në jetë dhe punë në bashkësinë shoqërore.

# Interview me mësimdhënësit lindë

1. A e perdorni kompjuterin? Per çfarë më shume?

FATBARDHA BUZUKU. Kompjuterin e perdori mjaft, mundohem me e perdor per planet, testet, e perdori edhe ne klase meqenese e kemi edhe në kabinet per të shfaqur edhe video të ndryshme.

ASTRIT IBROÇI. Më shume e perdori per mesim, e perdori edhe per përgatitjen e testeve dhe provimeve pastaj Poashtu kam një webfaqe ku ofroj më shume mesime per klasen time, plus edhe ofroj shërbim elektronik që nxenesit e kane emallin tim dhe dërgojne pyetje.

ARJETA IBROÇI. E perdori, por me teper e perdori per mesim, si per të gjetur gramatike më teper, per përgatitjen e testeve, per programe që janë per profesore si dhe per aktivitetet te lira që e bëjnë orën më interesante.

VALDET KURTI. Ma mori shpirtin, më qorroj. Meqenese është pjesë e profesionit tim e perdori per mesimdhenie, kurse pjesën tjetër per informim, komunikim, etj.

2. Çka i mungon shkolles sone më se shumti?

FATBARDHA BUZUKU. Shkolles sone më se shumti i mungon hapesira, gjegjesiht një shkollë më e madhe duke marre parasysh numrin e nxenesve.

ASTRIT IBROÇI. Nxemja qendrore, hapesira për akomodimin e nxenesve. Komplet infrastruktura duhet të ndryshoje.

ARJETA IBROÇI. Shkolles sone i mungojne shume paisje ne klase, si tabela, bankat, interneti që të mund të informonim nxenesit më teper, pastertia nuk është ne nivel, se pari mendoj per kabinetin tim.

VALDET KURTI. Hapesira, mungesa e librave per vitet III e IV, per lende dhe gjuhe te tjera, pikantet, etj.

3. Sa janë të organizuara aktivitetet e lira ne shkollen tone? A na mungon ndonjë aktiviteti vençant?

FATBARDHA BUZUKU. Pa pergjegje.

ASTRIT IBROÇI. Meqenese kam kryer gjysmen e gjimnazit ne perendim do te thote ne New York do te ishte bukur te kishim një salle per drame, apo per aktivitetet tjera.

ARJETA IBROÇI. Sa i perket ekskursioneve organizohen mjaft, por sa i perket koreve apo grupeve ne gjuhe te huaj mungojne shume.

VALDET KURTI. Jane dhe s'janë dhe n'varësi prej kujt. Aktivitetet janë pjesë perberëse e planit, mund te jene konkursi, një faqe interneti që do te jepte informacion cdo ditë, dhe një reviste më e shpeshte se FILMENI.

4. Çfarë mund te beni ju si profesor /është per një sukses me të mire të shkolles sone?

FATBARDHA BUZUKU. Ti aktivizoj nxenesit sa më teper, me e thy tabunë profesor nxenes, pastaj nxenesit sa më shume të marrin dijen me logjike e jo mesim motorë.

ASTRIT IBROÇI. Te vazhdoj punën që jam duke kryer me këtë energji të pashtershme.

ARJETA IBROÇI. Une personalisht mundohem mos me leju që të bëhen bisëda jashtë orës se mesimit por mundohem ti aktivizoj. Ajo ore është më interesante, neqoftëse kemi më shumë aktivitete.

VALDET KURTI. Une mendoj që nese realizohet aq permbytja e planeve ne menyre rigorozë, ne dalim shkelqyeshem.

5. Si janë raportet nxenes - profesor?

FATBARDHA BUZUKU. Sa i perket raportit tim me nxenes, une mundohem që ato te shprehin sa më lirshem mendimet, shqetësimet e tyre ne çdo aspekt.

ASTRIT IBROÇI. Sipas mendimit tim, mendoj që mungon respekti i duhur dbe shpesh marredheni nxenes - profesor perpiqet te jetë shok - shok.

ARJETA IBROÇI. Personalisht kam deshira me pas më teper respekt nxenesit ndaj profesoreve. Duhet te ekzistojë edhe një balance mes nxenesit dhe profesorit dhe të kuptojmë neqoftëse nxenesi ka një problem ose çanti i llojdur duhet ta respektojme ate gjë por edhe anasjelltas.

VALDET KURTI. Te kendshme, te mira, komunikimi i ndërsjellë i cili nxenesin e afroj te profesori ose amanitatis se pse të dyja palet marrin diçka nga njerit jetri.

# RACIZMI

Racizmi... Dukuri e pashmangshme e kesaj bote, një ironi e hidhur që ka ekzistuar dhe do te ekzistoje në të gjitha epokat, kulturat dhe kontinentet. Pse ne shoqeri dikush s'ka guxim të hedhe hapin e pare drejt asaj lar tesi?

N'eshte e drejtë që vetem shkaku i ngjyres se lekures, fese apo kombesise disa të jetojnë në villa luksoze, e të tjerët duke enderruar vetem hijet e tyre?

Dje, sot, nesër... ky fenomen s'ka ndermend te shuhet, eshte bere rutine e popullsise ne mbare boten.

Kur flasim për racizmin kemi shume gjera që ndoshta harrojme edhe t'i themi, pasi që kjo dukuri ka tronditur dhe vazhdon te trondise me shume se gjysmen e popullsise ne bote. Racizmi eshte ai që synon perjashtimin e tjetrit dhe te huajt, kerkon t'i ndaje njerezit ne kategori, që do te thote ndarje e shoqerise ne grupime te catuara, ku secilit nga keto grupime i moshën cilesi te caktuara perfshire s'era te ndryshme, si ate te mendimit, kultures, shoqerise, karakterit deri tek temperamenti.

Po, a s'jemi te gjithe qenie qe meritojme dashuri, jete pa brengë e dallime?

Nuk eshte njeiru ai që ka fuqi per te vene dore mbi latin e dikujt, por kjo i dedikohet mëmës natyre, e cila vendose per çdo gje që kemi: ngjyren, te metat, aftezite... Eshte per te qare kur degjohet duket folur se dikur, ne periudhen e kolonizimit evropian njerezit ishin thjeshte nje mall qe tregtohej e pikorish pre e ketij fati ishin shume popuj te ndryshem.

Kur njeriu nuk merr ate qe meriton, humb edo shprese dhe shenje per te vazhduar hapat drejt jetes. Mirepo sado qe eshte bere perpjekje per t'u arritur barazia mes njerezve, kjo ka qene vetem nje detyre pa zgjidhje, pasi që kjo nuk eshte realizuar dhe mundesia qe kjo do ndodhë eshte shume i vogel.

Sot ka ende të atille qe vdesin nga uria, e ne anen tjeter te atille qe s'iu mbani xhepi parate... Bote e emendur, apo jo?

Thone se racizmi eshte nje dukuri biologjike qe percillet brez pas brezi dhe se eshte nje i cili nuk shuhet. Por... nese ky fanar eshte realiteti i hidhur a thua gjithmone fati i te jete ne kthetrat e ngjyres, kultures dhe perkatesise kombetare?

Kete do e desh moje vete koha.

## Ndjemë qe s'të njoha

E takova ne banesen e fundit qe  
drejtohej nga lindja,  
Me duart e ngritura kah qelli  
E lotët ne drejtum te tokes ...  
Lehtas peshperita;  
"Nnjemë që kurrë s'të njoha"

Sikur

Diç më the

Diç kuptova ...

Sikur pyesje  
"çka u kry?!"

Jo, akoma  
sen s'u kry!

Lulet, Marrin jetë

Në fryshten tënë martire.

Nuk luftove

Por

luftën e Fitove.

Si i tillë Je

Lider.

Nnjemë, qe kurrë s'të Njoha!

Flutur Mustafa  
Prishtina  
IV-4

## Mall për buzëqeshje

Më nuk do të mërzitem  
nëse dikush do t'më lëndojë,  
por do të qesh e gjëzohem  
se kam hequr qafe dikë,  
dikë që s'më ka vlerësuar.

Më nuk do të mërzitem  
duke menduar se Zoti, ngan-  
jehërë,  
duket që nuk i dëgjon lutjet e mia,  
do të gjëzohem se ka Zot

Më nuk do të mërzitem  
mund të mbështetur gjithnjë tek  
Ai.

Thonë se është dhimbje  
kur të merr malli për buzëqeshjen  
e dikujt,

mendoj se është tragedji  
kur të merr malli

për buzëqeshjen tënë.

Buzëqeshni  
edhe kur duket,

se gjithçka po shembet!

Buzëqeshni për hir të jetës!

Nuk do të mërzitem  
nëse shoqëria, ndonjehërë,  
më lë në baltë,  
por do të qesh duke e menduar e  
kujtuar  
se të gjithë bëjmë gabime.  
Andaj, njerëz të përkryer nuk  
ka.

## Më shumë dashuri dhe më pak urrejtje

Shumë njerëz pyesin veten dhe të tjerët se çfarë është jeta, sepse askush s'ia di vlerën. Jeta është e mbushur me ndarje, me shumë trishtim e më pak lumturi, jeta është paraqësje e ferr, ajo është lumturi dhe tmerr

-Po ç'është në realitet jeta pa dashuri?

Ajo s'mund të imagjinohet, sepse po të mos kemi dashuri në këtë jetë plot vështirësi e sakrifica atëherë ne do të ishim të vdekur që nga lindja. Prandaj ajo është aromë për lulen e rinisë ëndërr që zgjatë shumë shkurt, përfat të keq. Dashuro sa të mundesh, sepse minutat e orës rrëshqash sin si uji në burim dhe çdo gjë e bukur mbetet një ëndërr, një kujtim.

Ai që s'di të dashurojë, ai s'di as të jetojë. Ai vetëm di të jetojë me urrejtjen dhe xhelozinë që duket se i lumturojnë jetën.

Urrejtja prish shpirtin e pastër të njeriut, ajo prish ëndrrat e bukura që shohin njerëzit, prish dëshirat dhe i vret ato ngadalë.

"Shumë duan ylberin, por më parë duhet të lagen në shi që pastaj ta shohin atë". Dha kjo thënia na lë të kuptojmë se duhet mposhtur urrejtja përf të mbjellur dashuri.

-Jeta, arë, përf të cilën duhet të punojmë përf të mbjellur dhe duke pasur në këtë mënyrë nën kontroll kohën nëpërf të cilën kalojmë.

Urrejtja është dhimbje, largojeni atë!

Urrejtja është trishtin që të sjell errësirë.

Hape zemrën o njeri!

Dashuro! Adhuro!

Sundo gjithçka që nga dheu nën këmbë e gjer tek rrezet e diellit që të ngrohin ty!

Ajo është thelli i shpirtit tënd.

Aida Mehmed  
Liridona Gjaku  
III-3

K

R

F

J

L

T

A

R

# Portret i një Maturanti

I  
 S'është portret i Zonjës Shnajder  
 As pikturë pa kornizë  
 Nuk qëndron në front  
 Vend nuk zë në prapavijë.

II  
 S'është ëndërr që endet neteve pa gjumë  
 As yll që ndiqon të ardhmen  
 Është e tashmja që vend po zë  
 Hapësiren e së shkuares pushton.

III  
 Është syri plot jetë i një të riu  
 Që ngajeta sdi c'të presë  
 Është ankthi i një maturanti  
 Shoqëria e tij , ku do mbesë ?!

IV  
 Do kërkohen rrugëve të trishtimit  
 Telajo pa ngjyra , bardh e zi  
 Pa udhëkryqe në rrëth vicioz  
 Rrëth e rrëth fatit , rrëth e rrëth shpirtit.

V  
 S'është autoportret i pikasos  
 As i Da Vinçit Mona Lizë  
 Është loti i maturantit  
 Që gërryen faqen e njomë.

VI  
 Gjithësia fjalën e fundit tha  
 Çdo gjeneratë do ndërrohet tjetër ska  
 Çdo lot do peshohet , çdo ditar do lexohet  
 Në natëën ku të pathënat thuhën.

VII  
 Në natën ku të gjitha janë hyjni  
 Të shoqëruara me Dionis  
 Pa verë , pa romantikë  
 Natë mature, një sekondë zgjat, kujtimet merr dhe ikë.

VIII  
 Fjalët që thuhen në fund  
 Fundin duan ta shmangin  
 Një fillim i ri për çdo fund  
 Një fillim i ri në jetën e çdo maturanti.

IX  
 Një strofë gdhendur ata e meritojnë  
 Ata që djersë tretën për të skalitur karaktere  
 Potreti i perkryer i maturantit  
 S'do ishte asgjë pa mundin e tyre.

X  
 S'është e lehtë të thuhet fjalë e fundit  
 As të gdhendet një skulpturë  
 Ne ishim , jemi dhe do mbetemi  
 Një Uliks që në vetvete s'u kuptuam asnjëherë.

XI  
 Do harrohemë edhe ne  
 Siç harrohet çdo gjeneratë  
 Siç harrohet çdo valë deti  
 Siç harron deti një pulbardhë.

XII  
 Në natën e fundit jemi vargje bodleriane  
 Pentagram betovenian  
 Klasike , modernizëm , traditë  
 Shkollë e mesme , të falem për çdo kujtim.

# Ekskursioni



JV2

Endhi edhe rradha tonë. Është moment plot kater vite këtë moment dhe tanj që mbaroi do të na mbetet gjithmonë në memorien tonë. Edhe pse ishin plot 10 ditë neve na u duk sikurse ishin vetëm disa orë, gjithçka kaloj shumë shpejt dhe ne mënyrë të mrekullueshme. Edhe pse kishim disa probleme gjatë rrugës, kjo nuk do të thotë se na ka prishur disponimin, në fakt është një gjë që e karakterizoj udhëtimin tonë. Ndonjëherë edhe problemet janë të bukura dhe të mbësin ne kujtese për një kohë të gjatë.

JV3

Dicka e tillë edhe në enderr është veshtrire të ndodhje. Ishtin ditë që mund të numerohen në gishtat e duarve, por që brenda tyre fshihet një aventure përrallore. Gjithçka ishte e perkryer... Pallatet gjigande, bukuritë e papërshkrueshme të natyrës, vallet malinjtëse të brigjetë të thyera, mbrëmjet e shoqëruara me tingujt melançolik të atyre qyteteve që rezatoni drite e shprese. Përveç bukurive që i zoteronin vendet e vizituara, shoqëria ishte ajo që e shkonte edhe më shum madheshtinë e gjith këtij perjetimi. Edhe pse do të donim të mos shkëputeshim kurr nga krahet e asaj endrrë, realiteti është se çdo gjë ka një fund. Ishtin ato kujtimet që do lënë gjurmë të pasqyreshme në zemrat tona.

JV4

Edhe udhëtimi me i gjatë fillon me hapin me të vogël. J tërë rrugëtini ynë njerëz Mesdhe ishte unik. Çdo moment i katuari u gdhend në kujtesën tonë si një eksperience pozitive sepse shërbeu që të njiheshim me kultura dhe njerez i ndryshëm, me llojlojshmeri traditash dhe legjenda. Ky ekskursion shërbeu përmes forcuar dhe më tepër lidhjen ndërmjet vete dhe poashtu bëm miq të rinj. Incidentet e ndodhura nuk ndikuani në disponimin tonë, përkundrazi çdo gjë e morëm me sportivitet. Slikur të më jepë mundësi të shkoja përsëri, asgjë s'do ndlyshoja sepse çdo gjë ishte më se perfekte. Fotoja në anën e majte tregon lumturinë tonë ku në prapavijë shkelqen i katër ne lukis qyteti i magjishëm i Monte Carlo.

JV5

Ekskursioni është një eksperience të cilën çdo nxeħes do ta mbaj neħs mend. Ai shizz dhjetadish me i bukur i vittit tē JV. Ne këto ditë jo vetem që shetisim dhe bejm qesi, por edhe mesojmë edhe shumë gjera të reja, njihemi me kultura të ndryshme dhe njerez të rinj. Ne si klase kemi patur një organizm shumë të mirë, s'kemi patur aza problem dhe jemi kenaqur me gjithçka. Kemi vizituuar tre nga vendet më të zhvilluara i Europës dhe nuk mund të veçojmë aza, sepse të gjithë na kanë pëllver njëj. Sicili prej nesh e përmend këtë eksperience çdo ditë, duke dashur që të kthejmë kohen pas dhe ti kalojmë ato ditë se paku edhe njëherë. Por pasi që kjo gjë nuk është e mundur, na mbetet vetem të urojmë që gjeneratat e ardhshme të kalojnë sa më mirë dhe ta shfrytëzojnë ato siç e kemi shfrytëzuar ne.

JV6

J menduam ato ditë mirë se si do ti kalonim. J menduam festat, gëzimet, te qeburci e kurresei lodhjet. Ishtin dhjetë ditë të paħarrueahme, te pakrahausueahme ne aza dħejta dītash tjetra. Ishto investimi më i mirë i jetes son. Më mirë një i shetitur se një i ditor thone. Aka që vetem ne televizor mund ta shihnim, deri sa ne e prekxem prekem endrren. Do tē aktrijen ne fuşħen e kujtesas tonë keto përfjetime dhe ne vitt do rriten e rrakku.

JV7

Ky ekskursion do tē mbegħi neħħasseen tone shumë gjat. Përveç faktit që kemi sbiluwar vende të reja dhe tē bukura, ky ekskursion ka sherbier që edhe shoqeria tone te forcohet më teper. Jeni njobur me kultura të ndryshme dhe njerez tē rinj. Ky ekskursion mibetet ne vettwe thesar dhe i pa perseritahem.

JV8

# Ekskursioni



Gladiatorët e së ardhimes.



Atje ku dielli ngrohë edhe natën... rrëzë mund të shqasheshin nga çasti në çast!!!



Duke u përgadit për mbrëmje. është koktel një litersh edhe sdin me e gjet derën e hotelit.



Duke u bërë gati për El Clasico. Tifozëria e Real Madridit ka mbërritur para kohe në Nou Camp.



Pdodh edhe kështu. Autobusi mbet në mes të rrugës. Ekuipazhi i dëshpëruar.



Vetëm 20 euro na munguan.



Muzikë live në autobus.



Prej 720 shtretërve, asnjëri nuk ishte i lirë.



Dora e Vandamit rikthehet në vend të vet.



Edhe pse autobusi na u prish, disponimin nuk e humbëm për asnjë sekond.



Rënikjo Huka na ka nxjerr probleme boll, kanë mendu personeli se ia qitim tynin hotelit.



Rëkshtu është kur nuk ka WC autobusi.



Kur shoferi rrrit shpejtësinë.



Dhe tanë për shpi... Relaxaakat

Ra ka shpëtu jetën kjo pashteta. Por për 10 vjet ska me na ra ndër mend me e shti në gojë.



# Ekskursion

## Nuk ishte endërr... Ishim pikërisht ne!

Çdo çast është melankolik derisa je në pritje që të ndodhë, fillon të krijoi sensin e gjëzimit brenda në shpirt ashtu si një libër ku para se ta fillosh leximin e tij të intereson ajo çfarë ai libër mban në përqafim. Çdo qenie e përsosur e universit jeton me shpresën se ndoshta në një ditë të re do takohen me çastin që do i ngul kthetrat përgjithmonë në zemrën e tij... Kurse ne si gjeneratë këtë diamant të çmuar na e sollën rrezet e para të një agu tectori, të cilin secili prej nesh do e ruajë në guacën e kujtimeve. Verona, Lido de Jesolo, Lloret de Mar, Barcelona, Nice, Cannes, Monte Carlo dhe Monaco, Venezia... a nuk është e gjithë kjo mjaft për një endërr që nuk do doje të zgjoheshe kurrë? Të gjitha këto janë lule që thurin kurorën e një ndjenje që nuk mundesh ta përvashish me fjalë. Eh, sa herë që pikat e lehta të shiut më lagin supet, më sjellin para vetes pallatin e

Romeos dhe Zhulietës, sa herë që rrezet e diellit marrin udhën e perëndimit, ndodhem në atë bregun ku gjithë Monte Carlon e mbaj në shuplakë të dorës, e kur flladi i freskët mi lëmon flokët më sjell përpara aromën e valëve të shkumbëzuara që përplaseshin me bregdetin e Nicës dhe

Lido de Jesolos, e sa herë që shoh ndonjë film, mu aty më shfaqet Kan-i. Sa herë që kaloj një urë hedh shikimin mos të jetë edhe një e dytë identike, si urat e Venecies së lashtë e cila e fshehur

mbas maskës së ballove madhështore ngallë dashuri në bankat e sajë romantike.

Po Barcelona??! Ëmbëlsira le të mbetet çdo herë për në fund. Për t'i përvashuar momentet në këtë gjytet, nuk ekziston fjalë që mund t'i përfshijë të gjitha! Ishte shoqëria ajo e cila këtë atmosferë e

bënte edhe më të bukur; përkrahja dhe dashuria e saj plot nëntë ditë ishte pa kufi. Janë çaste që i lamë pas... prej tyre mbeti vetëm hija e kujtimeve që do na përcjellë gjatë gjithë jetës. Edhe atëherë kur ftyrat tonë t'i mbulojnë rrudhat, edhe kur flokët të na jenë mbuluar me borë, do jetë ajo një fotografi që do na e sjellë buzëqeshjen e viteve rinore, duke i thënë vetes: "Nuk ishte endërr... Ishim ne... Isha pikërisht unë ajo që e përjetova gjithjë këtë".

# Kur nuk e njeh më veten

-Eshëtë e vështirë të shohësh se qëllimet tuaja të largohen nga duart... Eshëtë edhe më vështirë tek shesh qentë tjetër të të rrëmbejnë ashtin nga goja. Gjithçka po më largohet, bie edhe fati im më s'më qëndron pranë! Por, të luftoj me gjak ndër duar e dru ndër dhëmbë, që të më vrasë dhimbja nga plagët, këtë s'e kam ndërmend! Më mjalton të jetë i gjallë, i parruajtur, i pakrehur, i palatë dhe në mes të shiut të qëndroj... Më mjalton t'u shkoj juve sesi kriheni, hekuroseni, mbatheni, perfumoseni dhe shkonit... Shkonit për të jetuar jetën tuaj gjenjeshtër, shkonit sa për të tha të flokët tuaj e të mos fitohen! Se ju jeni ata që e quani veten "gentelman-a" e në atë moment që jeta ua lag pak kokët me pickla shiu e humbni atë emër!

-Po kush i bie të jem unë, unë kush jam? Çfarë kërkoj unë në mesin e tyre, pse po i vështroj sikur t'i njoh këta njerez? Mos ndoshta edhe i njoh? Po po i njoh, si farën e kuqe, i di mirë qëllimet e tyre dhe s'janë aspak të mira! A t'i fias njërit, a thua mos mua po më njeh ndonjën? I kujtohem kujt se si isha, si dukesha në gjimnaz, çfarë bëja? Gjithë c'kisha më thonin që ty jeta të buzëqesh. E cili sot më njeh e më bën përsë dyti shok, kujt prej tyre i nevojitet ky leckaman nëpër këmbë?

-Sikur të ndalonte ky shi e të mund thaheshë pak nga dielli që më ngrohte aq shumë dikur... tek rrija krah për krah me të, tek vendi sekret! JO, më mirë të vazhdojë e t'mi lajë gjynahet që kam bëre. Të mi pastrojë këto flokë që dredha më janë bëre, e këtë mjekërr që po më prek kërrthizën. Të mos ndalojë, le të fillojë dhe më rrëmbyeshëm të bjerë, se më kujton një ditë... më kujton "atë ditë"! Por gjithmonë kam qenë dymendjesh, mbasë


Kjo më solli këtu ku jam.

-Kujtoni që më bëjnë përshtypje gjérat luksoze. Kujtoni se unë nuk i kam provuar. I kam provuar s'pakut një herë të gjitha në ëndrra! Nuk ua kam zili "benz-ave", që më kalojnë nga këmbët, para syve, që nuk e ulin shpejtësinë fare e që s'duan t'a dijnë në më lagin mua. JO... as nuk i kam zili, as nuk i truaj (malikoj) se as ajo s'besoj të mbërrinë në veshin e kujt. Ka edhe nga ata që ndalen, ndalen aty buzë meje dñe sa filloj e buzëqeshi, dëgjoj një: "hup, hup nga muga". Fjalë e imja në veshë të shurdhët, gjithmonë thoja. Por tekxa unë po e taproja me fjalë, qelli duket se u lodh shumë nga fjalët e mia, vendos i të mos më durojë më. E lëshoi gjëmën e madhe, atë drithën e rufeshme dhe shiu filloj të rëndojë. Edhe pse kërkova që të binte, s'arita ta përballoj. Thjeshtë më bëri të ndërroj vend. Më bëri të shkoj aty ku nuk doja, më bëri të shkoj tek kasollja ime. Po, po e kam një kasolle...

-pesëmbëdhjetëkatëshe" e kam. Zënë vetëm dy veta brenda dhe kur isha me të, kur ishim bashkë të dy, atje Jashtë lija një pjesë të këmbëve! Por rraillë shkoj atje, shumë rraillë, shkoj vetëm atëherë kur nuk kam këtë mbështesë kokën përashta. Kjo kasolle më sjell aq shumë kujtime, e mbi të gjitha më kujton shikimet e saj, perkëdheljet, fjalët që mi thonte më aq endje e dashuri, të qeshurën e saj ma sjell ndër veshë dhe unë çmendem, s'duroj dot, s'prarioj faktin që sështë më në krahët e mi, që këto fjalë s'ka kush t'mi thotë më, e unë kujt t'a them ato pak gjëra që kam për të thënë mbi dashurinë, kujt t'a lag ndër krah me lotë këmishën e mëndafshi? Milletin kur ta zbraz kush do më kuptoj më sikur ajo! Dhe kur mu duk se drithë po agonte njehë dne përmua, retë vendosën ja shuanë atë nezë, vendosen t'ma rrëmbejn nga duartë të shtrenjtë time, gurin më të çmuar timin. Çlarë ditë me shtërgatë ishte kur humba atë... si sot!!! Tashti t'i kthehem mbrapshtë lutjes që bëra pak çaste më parë: do Zoti ndalon ky shi se kasollja ime e pa "aruar" sivjet duket se e ka humbur qëndrueshmérinë që kishte. Shpina i'u paska dobësuar me vite.

-Sikur të kisha një shok, por nuk kam, se pikërisht atyre ju "buzëqeshi jeta" e sot nuk mund të gjel as edhe një shok timin. Syri më ka parë lloj-lloj njerezish, por një profesionist human nuk e vura re në asnjë skutë. Po kërkoj një mjek. Si do të duket një mjek me mantillë të bardhë, prej shumë kohësh po sorollatëm vërdallë kësire trugëve, një s'e kam parë. Një moment... mos vallë aq shumë ka ndryshuar puna sa që as të bardhë nuk e veshin më mantillin, apo është zbuluar vaksina kundrejt të gjitha sëmundjeve të ndryshme... ska mundësi! Epo c'mendime po më sillen vërdallë në këtë kokë time të varfër. Po s'ke c'të bësh, ditë shiu e koka nuk të laget nën kasollen e drunjët e te kaibët, "fatmirësish te lagen vetëm këmbët"!

-Po pse vallë jetoj unë me kaq entuziazëm kur nuk kam asgjë? Si është e mundur që tek gjërat negative gjel arsyë për të jetuar, gjel pozitiven. Çfarë ngushiluesi... të ngushillosh velen në këtë kushtë thjeshtë të vjen "zor" kur të dëgjojë dikush! Sa duhet të jetë e madhe dashuria e një personi për jetën, që në këtë kushtë të dojë të vazhdojë të jetojë? I varfër quhet ai që s'ka asgjë dhe që askush nuk i jep gjë. Mirëpo tek ajo: "asgjë që i jep çdokush ai amri t'i gjel të gjitha"! Ky njen i varfër posedon thesarin më të larë e me të pastër. Mbi të gjitha dashurinë për këtë jetë! Ky jam unë!



KRUJIMIARI

# Krijëmtari botërore

Para se të dashuroja

Para se të dashuroja e dashur,  
asgjë s'ishte e imja:  
endesa rrugëve, midis sendeve  
asgjë s'kishte vlerë, as emën nuk kishte:  
vetëm ajër që priste ishte bota.  
Unë pashë sallone në ngjyrë hiri  
galeri të banuara prej hënës,  
hangare të pashpirtë në ndarje,  
pyetje që ngulnin këmbë në rënë.  
Gjithçka ishte bosh, e vdekur, e heshtur,  
rrëzuar, braktisur, lëshuar;  
gjithçka ishte e huaj, tjetësim  
e të tjerëve ishte dhe e askujt,  
qjersa bukuria jote dhe varfëria  
e mbushën vjeshtën me dhurata.

Pablo Neruda

Nëse unë vdes

E dashur, nëse unë vdes dhe ti je gjallë,  
e dashura ime, nëse ti vdes dhe unë mbeten gjallë,  
mos t'i japim dhimbjes më tepër vend,  
jo më shumë hapësirë se kjo që jetojmë!  
Pluhuri në grurë, erë që endet  
na bartën sì thermia lundruesse  
Mund të mos i shim gjendur në një kohë:  
ky lavigjku ne u takuan,  
oh pafundësi e vogël! Le të kthehem!  
Por kjo dashuri, e dashut, s'ka marrë fund:  
ashtu si nuk pati lindje  
as vdejë nuk ka - ajo është një lum i gjatë,  
që ndërron vetëm shtratin e brigjet.

Pablo Neruda

Sikur të kisha një copëz jetë... !!!

Sikur Zoti të harronte për një moment që unë jam një dordolec i ndrequr me rrecka dhe të më dhuronte një copëz jetë, mbasë nuk do ti thosha të gjitha ato që po mendoja, por sigurisht do ti mendoja ato që po them. Do i jepja rëndësi gjëra jo për vlerën, por për domethënien e tyre. Do fija pak, do ëndërroja më shumë, sepse çdo minutë që myllim sytë humbasim 60 sekonda dritë. Do vazhdoja kur të tjerët do ndalonin, do zgjohesh kur të tjerët do flinin. Do dëgoja kur të tjerët do flisnin, dhe sa do e shijoja një akullorë me cokollatë!!! Nëse Zoti do më jepte një copëz jetë, do vishesh shjeshtë, do shtrihesh përbalje diellit duke e lënë të pambuluar jo vetem trupin por edhe shpirtin tim. Ah Zoti im, sikur të kisha një copëz jetë, nëse do mundesha, do shkrueja urrejtjen time mbi akull, dhe do prisja të dilit dielli. Nuk do te lejoja të kalonte as edhe një ditë pa i thënë njerëzve që dashuroja se i dashuroja. Do të bëja çdo burrë dhe grua të besojnë se janë njerëzit që dua dhe do të dashurohen me dashurinë. Të njerëzit do të tregoj se sa gabim bëjnë kur besojnë se ndalojnë së dashuruari kur plaken, pa kuptuar se plaken kur ndalojnë të dashurojnë. Fëmijës së vogël do t'i jepja pendë, por do ta lija të mësonte vetë sesi të fluturojë. Pëqve do t'u tregoj se vdekjen nuk e sjell pëlegrinia por "harresa". Mësova kaq gjera nga ju, njerëzit. Mësova se të gjithë duan të jetojnë në "majen e malit", pa kuptuar se lumburia qëndron në mënyrën se si zbut "faqen e pjerrët".

Mësova se kur fëmija i porsalindur shtrëngohet mbi pëllëmbën e tij të vogël, për herë të parë gishti që zgjatet i babit të tij e robëron përgjithmonë. Mësova se njeriu ka të drejtë ta shohë tjetrin nga lartë, vetëm kur duhet ta ndihmojë të cohet.... Të thuash gjithmonë ate që ndjen dhe të bësh gjithmonë atë që mendon.. Nëse do ta dija që sot do të ishte hera e fundit që do të të shihja duke fjetur, do të të përqafaja fortë, fortë dhe do t'i lutesha Zotit që të bëhesha roja e shpirtit tënd. Nëse do e dija se kjo do ishte hera e fundit që do të të shihja të dilje nga dera, do të të përqafaja dhe do të të jepja një puthje dhe do të të thërrisja përsëri që të të jepja edhe të tjera. Nëse do ta dija që kjo do të ishte hera e fundit që do ta dëgjoja zërin tënd, do të regjistroja çdo fjalë tënden që të mund të të dëgjoja përsëri, përsëri.. Nëse do të dija që këto do te ishin momentet e fundit që do të të shihja, do të të thosha "të dashuroj" dhe do të supozoja jo logjikët se e dije më parë. Ekziston gjithmonë një e nesërme dhe jetë na jep edhe mundësi të tjera që t'i bëjmë gjerat siç duhet, por nëse bëjmë gabime na mbeten vetëm e sotmja. Do të doja të të thosha se sa shumë të dua dhe se kurrë s'do të të harroj. E nesërmja nuk është e sigurt për askënd, si i ri, si i vjetër. Sonte mund të jetë hera e fundit që i shikon njerëzit që do. Prandaj mos prit më, bëje sot sepse e nesërmja nuk vjen kurrë. Sigurisht do pendoresh për ditën kur nuk gjete kohë për një buzëqeshje, një përqafim, një puthje dhe sepse ishte i zënë për të realizuar një dëshirë të tyre. Mbajti ato që dashuron pranë vetes, thuaju duke mëmëritur se sa shumë ke nevojë për ta, dashuraj, sillu mirë, gjëj kohën për ta, thuaju "më vjen keq", "më fal", "falaminderit" dhe të gjitha fjalët e dashurisë që di. Asnjëri nuk do tă të mbajë mend për mandimet e tua të fshehta.....

# Pjesa zbavitëse

## Anekdotë

-Dialogu mes mendjes dhe gotës së alkoolit-

Gota 1: tak, tak ,tak... Mendja: Kush është? Gota 1: Jam unë, gosta e alkoolit.

Mendja: Po nuk ka vend. Gota 1: Po si të mos hy kur erdha deri

këtu? - dhe hynë.Pas pak bie dera sërish- Tak , tak, tak...-

dhe po me të njëjtën mënyrë hyjnë edhe

gosta e dytë dhe e treta. Nga ngushtimi

mendja po bezdisej sa s'ka. Kur ja behu

sërish dera. Ishte gosta e katërt...

Mendja: Nuk ke për të hyrë dhe pikë.

Gota 4: Pse ato hynë e unë jo? Mos

janë më të mira se unë?

Mendja: Nuk i lashë unë, por hynë

me zor.Gota 4: Edhe unë me zor do

të hyj.Mendja : Ashtu ë? – thirri


mendja gjithë inat – Epo hy ti, se

po dal unë atëherë! Mendja del

dhe gotat fillojnë valle në

kokën e njeriut!

## Fjalëkryq



## Horizontalisht

- |  |  |
|--|--|
| 1 Shtet evropian.                        | 29 Anviku.                                 |
| 7 Fshehje e diçkaje.                     | 31 Dukati.                                 |
| 13 Grupet qe plaçkisin.                  | 32 Maja e mbiellit.                        |
| 14 Kongresmeni, Engel (shq.).            | 36 Semundje qe shfaqet me zenien e frysme. |
| 15 Emri i kengetares, te njojur si Tuna. | 40 Aktorja, Muçaj.                         |
| 16 Syzë.                                 | 41 Gershetoj fijet e perit.                |
| 17 Times Interest Earned.                | 43 Pasuri e patundshme.                    |
| 18 Figura kishtare.                      | 44 Unix Desktop Environment.               |
| 20 Extinction Level Event.               | 45 Nisje, fillim.                          |
| 21 Variant i emrit Ymri.                 | 47 Epoka.                                  |
| 23 Ajo qe lidh brigjet e nje lumi.       | 48 Rinderoj.                               |
| 24 Variant i emrit Elenë.                | 50 Qesendises.                             |
| 25 Kuftoma, xhenazja.                    | 52 I dashuri i Fitnetes.                   |
| 27 Vendbeteje e Skenderbeut.             | 53 Piktori, Aziz.                          |
|  | 54 Nisme.                                  |
|  | 55 Kopjim.                                 |

## Vertikalisht

- |  |   |
|--|---|
| 1 Permbushje.  | 26 Kryeprokurorja shqiptare, Rama.      |
| 2 Valevitje (sh.pashq.).                                     | 28 Sahati.                              |
| 3 K.F. Italian.  | 30 Plakje.                              |
| 4 Parti e njojur gjermane.                                   | 32 Mungese urtie.                       |
| 5 Ish-futbollisti gjerman, Uve.                              | 33 Ish-futbollisti, Kozniku.            |
| 6 Vend ne Bangladesh.  | 34 Regjisori i njojur amerikan, Kubrik. |
| 7 Mesi i nates.  | 35 Kengetarja, Oksa.                    |
| 8 Heroi, Gjergj Elez.  | 37 Mjet transporti (sh.shq.).           |
| 9 Zoteri (ang.).   | 38 Humanisti, Barleti (Shq.).           |
| 10 Kelysh maceje.  | 39 Mesymje.                             |
| 11 Paraardheset e Italianeve.                                | 42 Lumi me i gjate shqiptar.            |
| 12 Familie e sakrifikuar per lirine e Kosoves (Fush-Kosove). | 45 Pjese e lojes se pingpongut.         |
| 19 Valle ballkanike.   | 46 Guximtar.                            |
| 22 Vendlindja e Odiseut.                                     | 49 Maçok.                               |
| 24 Futbollisti, Fetahu (shq.).                               | 51 Njesia e rezistences elektrike.      |

# SPORTE



## Ligji i pashkruar i futbollit: "Kur nuk shënon, e pëson"

Për ndryshim prej viteve të mëparshme maturantët insistuan që këtë vit të organizohet turniri në futboll. Iniciativa e tyre rezultoi e suksesshme. Fillimisht u diskutua në parlamentin e nxënësve e më pas u miratua nga drejtori i shkollës. Ishte risi dhe këtë turnir e mirëpritën të gjithë nxënësit e shkollës. Disa morën pjesë në mënyrë aktive, kurse të tjerëve u ngeli të ishin tifoz të skuadrave. U paraqiten 16 ekipe. Ku xhiroja e parë u mbajt në terenin e hapur sportiv të shkollës, ndërsa ndeshjet tjera në sallë. Spikatën dy klasë (skuadra), IV-2 dhe III-11 ku arritën deri në finale e këtij turniri. Të dyja skuadrat kishin vështirësitet e veta por në fund e shpërblyen besimin dhe pritëshmërinë që kishin tifozët. Skuadra fituese ishte III-11, ku finalen e fituan me rezultatin e ngushtë 3 – 2. Ndeshja ishte mjaft e mire dhe emocionuese me kthim të difishtë të rezultatit. Fillimisht 1-0 për fituesit, pastaj 1-2 dhe në fund ndeshja përfundoi me rezultatin e lartëpërmendur.

### FINALJA



3 - 2





# ESPORT

## Klubi i Karatese "Ulgini"


Më 02.03.2013 u mbajt Kampionati i Malit të Zi për Seniorë, ku KK "Ulgini" u rendit në vendin e tretë në plasmanin gjeneral. Nga radhët e KK "Ulgini" u shpallën 2 nënkampionë në disiplinën individuale, ndërsa dy ekipe e vajzave shpallën nënkampionë ne luftëra dhe kata. Po ashtu me medalje të bronzta u kurorëzuan 2 garues dhe ekipi i seniorëve në luftëra dhe kata.

Nënkampione e Malit të Zi në luftëra individuale u shpallën Seida Suma +68kg dhe Hantije Ibroçi -68kg. Me medaljen e bronztë në luftëra individuale u kuro-rëzua Dardan Ceka -60kg dhe Albion Duraku -60kg. Ekipi në luftëra dhe kata i vajzave ishte i përbërë nga Seida Suma, Hantije Ibroçi dhe Antigona Rama, ekipi i meshkujve në kata ishte i përbërë nga Dardan Ceka, Petar Barlloviq dhe Edin Kraja, ndërsa në luftëra ekipore Petar Barlloviq, Dardan Ceka, Albion Duraku, Allmir Hajdari dhe Edin Kraja.

Po ashtu disa prej nxenesve te Klubit te Karatese Ulgini do marrin pjesë ne Kampionatin ballkanik, që do mbahet ne fund te muajit Mars ne Serbi me reprezentacionin e Malit te Zi.



# Muzikë



VIT DALLOMË



## Ardian Lulgjuraj

Edhe pse Ulqini është vend i vogël në pëndim individual ka me cka të mburret, Sidonie artin e muzikës, aty ku dita e ditës zot është këngëtare që fjalë për Adrian Lulgjuraj, i njohur në Ulqini si "SEXY VERY MUCH". Mirëpo në 2010 ai depërtoi në show-tv televizive shqiptare si solist. Në Top Fit arriti deri në finale dhe fitoi dizajnën - Adriani vazhdoi me punën e palodhesh, dhe me suksesin e rradhës, fitoi festivalin "Shqipëria e Këngës" që organizohet nga kanalit televiziv shqiptar. Me këtë fitore Adriani fitoi të drejtën të përfshesjes së Shqipërisë në Eurovision.

Sukcesi në Eurosong dha mos të jetë kurrë suksesi i fundit për Adriannin.

## Dino Zhygjeli

Dino Zhygjeli është ulqinaku i cilët ka bërë "BOOM" në rradhës në fushën e muzikës. Për ne ulqinakët është i njohur talenti i tij për këngën, por ai këtë i a është më shumë minitëre shqiptarës në spektaklin "THE VOICE OF ALBANIA" duke mbartur me vete Ulqinin dhe historinë. Aty arriti deri në gjysëmfinale, na bëri të enderronin finale pse jo dhe vendin e parë, dridheshim nga emociionet. Mori lëvdata nga më të mëdhenjtë e Shqipërisë, i është pak! Djepi i Ulqinit ka ditur të rrëzë kulturën dhe vazhdon ta bëjë këtë në mënyrën e dhurimit. Dino është në studime në Tiranë kujthërit edhe këndon në publik me grupin e tij. I urojmë Dinos suksesë në vazhdim.

## Armend Milla

Armend Milla, vokalist dhe instrumentalist i shëton vlerat larmishëmërisë muzikore të Ulqinit. Është 24 vjeç. Shkollën e muzikës përmes piano e ka kryer në Ulqin ndërsa dy vite ka studuar përmes Kanto. Citojmë fjalët e tija: "Muzika përmua është një pasion që energji negative e shndërron në energji pozitive. Zerin dhe veshin përmes muzikës kam marrë nga gjyshi dhe babi dhe gjetja familjje muzika është pjesë e jetës sime. Në kohë të lire luaj piano dhe gitare", Armendi poashtu ka fituar me grupin e tij spektaklin "Ethet", ndërsa tanë është një ndër konkurrentët e "Top Festit". Ju urojmë sukses!

# Kulturë dhe art

## Vitrina e librit

L  
e  
t  
e  
r  
s  
i  
o  
  
s  
h  
q  
i  
p  
t  
a  
r  
e

L  
e  
t  
e  
r  
s  
i  
o  
  
b  
o  
t  
e  
r  
o  
r  
e



"Dragoi i Fildishte" nga Fatos Kongoli

"Një natë dhe dy agime" nga Petro Marko

"Shkaba" nga Ismail Kadare

"Kaloresi Lakuriq" nga Dritero Agolli

"Te jetosh ne ishull" nga Ben Blushi



"1453" nga Roger Crowley

"Miliarderët aksidentalë" nga B. Mezrich

"Komendia hyjnore" nga Dante Aligieri

"Uliksi" nga James Joyce

"Parajse Sigurie" nga Nicholas Sparks



Merlinda Mollabeqiri



Merlinda Mollabeqiri



Aida Beciq

## Thënie:

Dora e butë thyen edhe gurin më të fortë, fjala më e embël zbutë edhe zemrën më të egër.

Nese fati nuk troket, krijo një derë!

Hapi dyert e optimizmit në zemrën tënde, që të hyjnë rrezet e shpresës nga dielli i perku jdesit hyjnоре, i cili është mbi kokën tënde...

Asnjëherë mos ja thyej shpresën dikujt, sepse ndoshta është gjëja e fundit që ka!

Njerëzit mund të kalojnë një oqean pa i lagur këmbët, por nuk mund të kalojnë kurri jetën e tyre pa i lagur sytë.

Pesimisti gjen veshtrësi në çdo rast, optimisti gjen rast në çdo veshtrësi.

Njerëzit që s'gjejnë mjafte interes tek vetja e tyre, merren me punët e botës.

Përblohdhen:  
Shehide Elezoviq  
Rrezarta Doda  
Ermelinda Sellaj

# Testamenti

Shoqëri e arsimtarë çdo gjë përfundoi  
thua se dje ishim n'vit t'parë por çdo gjë shpejt kaloi  
shumë shpejt mbaroi e kujtimet do mbesin  
e po i lëmë edhe ne ca fjalë që s'do tresin  
se në mesin e juaj morëm edukim  
t'gjith ishim të huaj e tanë do mbesim si një kujtim  
pa përjashtim të gjithëve ju deshëm  
edhe pse rrallë e shprehëm e shpesh heshtëm  
n'fillim ju dreshtëm se ju morëm për t'vështirë  
po më pas s'bashku kaluam kohën me t'mirë  
gjenerata më të mira po vijnë përcdo vjetë  
e ne po i lëmë më t'mirë se i kena gjetë  
e po t'na pysni neve me 94'-sh nuk ka  
katër vite n'kët shkoll e një problem se kemi ba  
mungesat me i pa kanjiher me zor i zinte ditari  
po zor edhe më i madh kur i shikonte kujdestari  
e për së pari këtë vit ne s'duam t'permendim emra  
s'duam dikënd ta shtyjmë e dikënd ta mbajm te zemra  
se nga koka tek themra jemi njësoj sbëjmë dallime  
e po e shkruajmë edhe thjeshtë që mos tju lëmë në dyshime  
shum duhen ndryshime, shum gjëra ti shtonit  
jo ieshime po mirëkuptime e nxënësit mos i përjashtonit  
ju lutemi na kuptoni sa na keni nëpër duar  
mos e paragjykonit një mendje të padjallzuar  
se këtu e kemi krijuar pak a shum personalitetin  
ë ndoshta një ditë do ta përfaqsojmë ne qytetin  
fakulteti po na pret shpresojmë të jemi të përgatitur  
dituria na kaloi ndër duar shpresojmë ta kemi grabitur  
në fillim mezi prisnim të kalonim ne të katërtin vit  
po tanë që jemi këtu nga na ikën gjithë ato ditë  
"po kështu e kanë të rinjtë se vlersojnë çka kanë ne dorë"  
po na dalin fjalët e juaja o të dashurit profesorë  
e ne një gjë kishim me zorë - në mëngjez që të zgjoheshim  
po në atë mengjez e gjith shoqëria grubullohesim  
ato ditë po shkojnë sna kan mbetur edhe pak  
e ju kerkojmë nga ju qe të jeni më tolerantë  
ne të gjitha anët shpresojmë që të hecim  
e i falemnderojmë ata qe akoma na mbështesin  
së bashku ju përshëndesim të gjithëve në këtë vend  
e shpresojmë qe ndër vite tju mbesim ndër mend.